



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
NJËSIA E PROKURIMIT

*Ballsh, më 30.05.2024*

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM  
(KY PROCESVERBAL ËSHTË PËR EFEKT PUBLIKIMI BASHKË ME  
DOKUMENTET E TENDERIT)**

*Objekti i prokurimit: “Ndërtimi i shkollës “Gjokë Doçi”*

*Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45214200-2*

*Vlera e fondit limit: 159,811,598 (njëqind e pesëdhjetë e nëntëmilion e tetëqind e njëmbëdhjetë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH (i cili përbëhet nga shuma “punime...” me vlerë 154,009,006 lekë pa TVSH dhe shuma “pajisje...” me vlerë 5,802,592 lekë)*

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesë blerjes (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës dhe Lista e Çmimeve sipas Shtojcave 1 dhe 2;

*Argumentimi:* Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenet 26, 29 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet (jo më e vogël se 50 % e vlerës së fondit limit).

*Argumentimi:* Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, duke mbajtur në konsideratë edhe nivelin referues të punëvs së ngjashme që kërkohet nga legjislacioni i prokurimit publik. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi

*të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të paraqitura pranë Administratës Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu, OE duhet të paraqesin edhe akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar në rast se janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”. Gjithashtu, kërkesa lidhur me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar, bazohet në nenin 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë

*periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**2.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Argumentimi:** *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.*

### **2.3. Kapaciteti teknik:**

**Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:**

#### **2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 75,000,000 (shtatëdhjetë e pesëmilion) Lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se 300,000,000 (treqindmilion) Lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Në rast se oferta paraqitet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2.3.1, gërma “a”, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1, gërma “b”, duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente/institucione publike, OE duhet të paraqesë:
  - Formular vlerësimi sipas shtojcës 9;
  - Kontratë sipërmarrje;
  - Situacion përfundimtar;
  - Faturat tatimore
  - Akt kolaudimi;
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesë:
  - Formular vlerësimi sipas shtojcës 9;
  - Kontratë sipërmarrje;
  - Situacion përfundimtar;
  - Akt kolaudimi;
  - Faturat tatimore;

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh ekonomikë, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, të jenë minimalisht në vlerën prej jo më pak se 75,000,000 (shtatëdhjetë e pesë milion) Lekë pa TVSH për një objekt të vetëm (vlerë e cila nuk është më e madhe se 50% e fondit limit), ose në vlerën prej jo më pak se 300,000,000 (treqindmilion) Lekë pa TVSH për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit (vlerë e cila nuk është më e madhe se dyfishi i fondit limit).*

*Gjithashtu, referuar nenit 88, pika 3, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim*

*operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”. Puna e ngjashme shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara në këtë kërkesë, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për autoritetin kontraktor, me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

*Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar nenit 77, pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 39, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

*Në kuadër të vlerësimit të ofertave në menyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë apo punimeve të kryera me nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga institucioni përkatës. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qenë anëtar i një bashkimi operatorësh ekonomikë ashtu edhe në rastet kur ka qenë në rolin e nënkontraktorit. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo operator në dosjen e tij, e për rrjedhojë nuk sjell kufizim për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi.*

*Kërkesa për përvojën e mëparshme është ndër kërkesat e rëndësishme që garanton Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie dhe gjithashtu kjo kërkesë është në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik në fuqi.*

**2.3.2.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërise për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtëme:

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë
- NP-2 C Ndërtime civile dhe industriale
- NP-7 A Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- NS-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
- NS-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- NS-18 A Punime topogjeodezike

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, ku janë të disiplinuarat procedurat përkatëse të licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit. Gjithashtu, kjo kërkesë referohet edhe në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar,*

ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore...”.

Pikat dhe kategoritë e kërkuara në licencë, janë përcaktuar në bazë të zërave dhe vlerave të parashikuara në preventivin e punimeve të projekt-zbatimit.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban preventivi për çdo zë pune mbështetur në VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të ofertuesve në kuadër të veprimtarisë objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Gjurmim themele e plinta b~2m, ekskavator me goma, kova 0.25m <sup>3</sup> shkarkim auto	Kategoria A	0-20 milion lekë
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak Nenshtrese zhavori 30cm nen pllaken e themelit shirit Shtrese betoni C 12/15 nen plinta Plinta e bazamente b/a monolite C - 30/37 Trare themeli b/a C - 30/37 monolit Soleta te plota b/a C - 30/37 Soleta b/a me traveta polisterol dhe rrjete teli C 25/30 t=30cm, h~6m Trare e arkitrare b/a C25/30 h ~ 4m Kollona dhe mure b/a monolite C 25/30 h ~ 4m F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm Konstruksione metalike te perbera	Kategoria C	51 – 100 milion lekë



		<p>Mbulim çatie me panele sanduich  Shtrese betoni C 16/20  Shtrese rere  Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak  F.V porte metalike ne hyrje  Mure b/a t = 21 ~ 30 cm, C 16/20, h ~ 4 m  F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm  F V hekur betoni periodik Ø &gt; 10 mm  F.V shkalle te plota b/a C 30/37 + rampa  Boje bikomponente (paste) Vijezi me sinjalistike bodrumi  Lyerje betoni me hyperdesimo ( muret)  F V tub drenazhi Ø 150 mm  F.V. Protefon per mbrojtjen e h/i per bodrumin  Nenshtrese zhavori  Shtrese betoni C 6/10</p>		
NP-7	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje, naftësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës	<p>F.V tuba plastik te brinjëzuar kuz, Ø250 mm  Furnizim vendosje tuba të brinjëzuar, Ø315mm  Furnizim vendosje tuba të brinjëzuar, Ø400mm  Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me zgare gize  Kunete me zgare metalike B= 25 cm  Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m  Shtrese rere  F.V Pompe drenazhi zhytëse me thike per heqjen e ujit Q= 4m<sup>3</sup>/h H=6 m P=0.55  Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak giz  F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjëzuar</p>	Kategoria A	0-20 milion lekë
NP-11	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.	<p>Kanaline metalike 210x65  F.V.Tub PVC fleksibel i forte vetshuare Ø 20mm  F.V.Tub PVC fleksibel i forte vetshuare Ø 25mm  F.V.Tub PVC fleksibel i forte vetshuare Ø 32mm  F.V kuti suport pllaket 2 modular  F.V kuti suport pllaket 4 modular  F.V Tub rixhid i ngurte d=20  F.V Tub rixhid i ngurte d=25  F.V Tub rixhid i ngurte d=32  F.V Percjelles fleksibel N07V-K 1,5mm kundra zjarrit  F.V Percjelles fleksibel N07V-K 2,5mm kundra zjarrit  F.V Percjelles fleksibel N07V-K 4mm kundra zjarrit  F.V Percjelles fleksibel N07V-K 6mm kundra zjarrit  Kabell FR-OR 450/750V fleksibel 3x1.5mm  Kabell FR-OR 450/750V fleksibel 3x2.5mm  Kabell FR-OR 450/750V fleksibel 3x4m  Kabell FG7OR 06/1KV fleksibel 5x6mm  Kabell FG7OR 06/1KV fleksibel 5x16mm  FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086  F.V. Elektroda tokezimi te zinguara L = 1.5m  F.V. Shirit Zink dim 30*3 mm  F.V. Percjelles bakri i i zhveshur 1x 50mm<sup>2</sup>  F.V. Morseta bashkuere T-I &amp; kryq universale  F.V. Kubike te gatshem betoni 40/40/40 mm  F.V. Puseta per elektroda 0.5x0.5x0.5  F.V. Germim, transport dhe mbushje dheu  F.V. Shkeputes per matje komplet &amp; kuti PT-5;Ip-65 , me she</p>	Kategoria A	0-20 milion lekë

		F.V. Shtiza me maje te zinguara d=16 mm ; L=0,6 ml F.V. Morseta suportte me zbritje me bulon kapje e mberthimi per Zn.30*3mm		
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje e instalimeve elektrike Prishje e instalimeve hidraulike Prishje soleta + strehe dhe shkalle beton arme Prishje shtresa ekzistuese betoni Prishje mur tulle me pastrim Prishje e arkirareve beton arme Prishje themele beton arme Heqje dyer te brendeshme Heqje dritare e vetrata Heqje davancalet granili ose materiale te tjera krejtesisht Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	Kategoria A	0-20 milion lekë
NS-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Shtrese rere F.V. Saracineske nentokesore me aks te gjate dhe puseta gize komplet per lidhjen e furnizimit me uje nga rrjeti urban  F.V Valvol nderprerese DN 50 (Ø 2" ) F.V Tubo PE - HD Ø 63x6.8 mm, PN10 + rakorderi F.V. Reduktor presioni DN 50 (Ø 2" ) F.V. Reduktor presioni DN 40 (Ø 1 1/2" ) F.V. Reduktor presioni DN 32 (Ø 1 1/4" ) F.V. Reduktor presioni DN 25 (Ø 1 " ) F.V Filter Y Ø 2" F.V Valvolmoskthimi Ø 2" F.V. Mates uji Ø 2 " F.V Tubo PEX/al,DN 12 (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar δ= 6mm F.V Tubo PEX/al,DN 12 (Ø20 X 2.0) mm, i termoizoluar δ= 6mm F.V Bryla AL-PEX Ø16x1/2 F, me prese F.V Bryla AL-PEX Ø25x4.2 F, me prese F.V Elemente mberthyes e fiksues F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR , Ø25 X 4.2 mm PN 16 F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR , Ø32 X 5.2 mm PN 16 F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR , Ø40 X 6.7 mm PN 16 F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR , Ø50 X 8.3 mm PN 16 F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR , Ø63 X 10.5 mm PN 16 F.V Saracinesk kendore me hollandez 3/4" F.V Saracinesk kendore me hollandez 1 1/4" F.V Set kolektorresh 1 " ( 3 ) x 1/2" (kit I kompletuar me buketone + kasete)	Kategoria A	0-20 milion lekë

		<p>F.V Set kolektorësh 1 1/4 " ( 4x2 ) x 1/2" (kit I kompletuar me buketone + kasete)</p> <p>F.V Set kolektorësh 1 1/4 " ( 3x2 ) x 1/2" (kit I kompletuar me buketone + kasete)</p> <p>F.V Set kolektorësh 1 1/4 " ( 3x3 ) x 1/2" (kit I kompletuar me buketone + kasete)</p> <p>F.V Elemente mberthyes e fiksues</p> <p>F.V Valvol nderperrese Ø1 1/4" PN10</p> <p>F.V Valvol nderperrese Ø1 1/2" PN10</p> <p>F.V Valvol nderperrese Ø 2" PN10</p> <p>F.V Valvol nderperrese Ø 2 1/2" PN10</p> <p>F.V Valvolmoskthimi Ø 2 1/2 "</p> <p>F.V Xhunto antivibruese Ø 2 1/2"</p> <p>F.V Galexhent mekanik Ø 2"</p> <p>F.V. Galexhand elektrik</p> <p>F.V Pompe e furnizimit me uje Q= 8.4 m3/h H=37 m P=3.3kë</p> <p>F V rezervuari zingato 5000 litra</p> <p>F.V Tuba shkarkimi PP Ø125</p> <p>F.V Tuba shkarkimi PP Ø110</p> <p>F.V Tuba shkarkimi PP Ø75</p> <p>F.V Tuba shkarkimi PP Ø50</p> <p>F.V pilete dyshemeje Ø 50 mm</p> <p>F.V Tuba shkarkimi PP Ø110</p> <p>F.V Tuba shkarkimi PP Ø75</p> <p>F.V lavaman porcelani importi me mishelator</p> <p>F.V ËC allafrenga importi</p> <p>F V bolier 80 liter, uje te ngrohte</p> <p>F V bolier 12 liter, uje te ngrohte</p> <p>F.V lavaman porcelani importi per pak</p> <p>F.V ËC allafrenga importi per pak</p> <p>F.V pjate dushi</p> <p>F.v grup I kompletuar per dushet</p> <p>F.V bide importi porcelani</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 1 "</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 1 1/4 "</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 1 1/2 "</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 2 "</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 2 1/2 "</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 3 "</p> <p>F.V tuba zingato dhe rakorderi Ø 6 "</p> <p>F.V Valvol nderperrese</p> <p>F.V Lidhja me motopompen (AL-5121-B)</p> <p>F.V Hidrant zjarri (AL-5212-B)</p> <p>F.V Fikese zjarri me pluhur (AL-5203-B)</p> <p>F.V Buton sinjalizimi zjarri (AL-5102-B)</p> <p>F.V Drejtim dalje emergjence (AL-5107-B)</p> <p>F.V Zbritje shkallesh (AL-5103-B)</p> <p>v Fikëse zjarr pluhur karelato, destinacioni per depozitat e lendes djegese, transformatorin. Tip karelato (e levizshem). Klasa e zjarrit A-B1-C, kapaciteti normal 50 kg, pesha 82.5 kg. Dim. 500 x 1100 x 600 mm</p>		
--	--	--	--	--

		<p>V.Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI 9227, me baze rezine. Dimensionet (370x610x190) mm, tub fleksibël 30 m, Aksesorët: saraqineske ndërrprerëse 1½", lançë + zorre uji DN 45. Pjesa e përparme e mbyllur me çelës.</p> <p>.v fikse zjarri me pluhur 6kg</p> <p>.v mbulesa tekstili (batanije) kundërzjarr</p> <p>.V Pompe per furnizimin me uje hidrantet</p> <p>- Prurja: 60 m³/h,</p> <p>- Fuqia elektrike: 2.52 kË, ,</p> <p>- Ushqimi: 3F/400V/50Hz,</p> <p>- Shkalla e Mbrojtjes IP 55</p> <p>E kompletuar me te gjithë aksesoret e nevojshem.</p> <p>F Fikëse zjarr pluhur karelato, destinacioni per depozitat e lendes djegese, transformatorin. Tip karelato (e levizshem). Klasa e zjarrit A-B1-C, kapaciteti normal 50 kg, pesha 82.5 kg. Dim. 500 x 1100 x 600 mm</p> <p>F.Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI 9227, me baze rezine. Dimensionet (370x610x190) mm, tub fleksibël 30 m, Aksesorët: saraqineske ndërrprerëse 1½", lançë + zorre uji DN 45. Pjesa e përparme e mbyllur me çelës.</p> <p>F.fikse zjarri me pluhur 6kg</p> <p>F. mbulesa tekstili (batanije) kundërzjarr</p> <p>F.Pompe per furnizimin me uje hidrantet</p> <p>- Prurja: 60 m³/h,</p> <p>- Fuqia elektrike: 2.52 kË, ,</p> <p>- Ushqimi: 3F/400V/50Hz,</p> <p>- Shkalla e Mbrojtjes IP 55</p> <p>E kompletuar me te gjithë aksesoret e nevojshem.</p>		
NS-3	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	F.v Ashensor mekanik	Kategoria A	0-20 milion lekë
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike	<p>Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25</p> <p>Mur me tulle me 6 vrima,, h~3m, llaç perzier M15</p> <p>Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m dhe kolloncina</p> <p>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm</p>	Kategoria B	21 – 50 milion lekë

	ndërtuese	<p>Ndertim muri me knauf t=10cm me dy shtresa, kunder lageshtires</p> <p>Ndetim muri me knauf t=10cm me dy shtresa</p> <p>Shtrese me pllaka porcelanat importi</p> <p>Plintuse grez importi, h = 10 cm</p> <p>Veshje me pllaka ( NH/S)</p> <p>Hidroizolim me dy shtresa mapej ( NH/S)</p> <p>Shtrese pllaka mermeri t=3cm ( Shkallet )</p> <p>Shtrese lluster çimento 1:2</p> <p>Shtrese betoni i lehtesuar</p> <p>F.v Shtrese kundra vibrimit dhe zerit</p> <p>F.v Shtrese tartani, t=1.2cm</p> <p>Shtrese lluster çimento 1:2</p> <p>Shtrese betoni I lehtesuar</p> <p>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama</p> <p>Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm</p> <p>Shtrese avullizoluese gjeotekstil</p> <p>Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m</p> <p>Parapeti nga brenda</p> <p>Boje hidroplastike importi cilesi e I-re</p> <p>Shtrese me granil dekorativ</p> <p>Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25</p> <p>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me pompe</p> <p>Boje hidroplastike importi cilesi e I</p> <p>Patinim muri allçi (stuko)</p> <p>Dyer e hyrjes kryesore sipas VT</p> <p>V F dyer te brendeshme KLASA sipas VT</p> <p>F.V. Dere kundra zjarrit REI60 te pajisur me doreze antipanik dhe mekanizem mbylles</p> <p>F.V dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m2</p> <p>F V dritare d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re.</p> <p>F V dyer tualetii sipas vt</p> <p>F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>Shtrese pllaka mermeri t=3cm</p> <p>Vetrato xhami i temperuar</p> <p>Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato, h=80~90cm</p> <p>Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjete + suva.</p> <p>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 3 shtrese katrama</p>		
NS-12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	<p>Kaldaje çeliku (grup termik), lenda e djegeshme peleta, Kapaciteti Q=464 kË. Eficenca 80- 87%.</p> <p>Kompletuar me depoziten e lendes djegese peleta, bashke me sistemin e furnizimit automatik me lende djegese (shnek), e pajisur me te gjithë komponentet e sigurise dhe kontrollit si dhe aksesoret e nevojshem si dhe pompen antikondense te inkorporuar.</p> <p>Pompe qarkulluese binjake ( 1 Stand By) - primare e Kaldajes, 26500</p>	Kategoria A	0-20 milion lekë

		<p>l/h, 70 kPa</p> <p>Pompe qarkulluese binjake ( 1 Stand By) - e impjantit te ngrohjes per katin perdhe. Prurja 8 m<sup>3</sup>/h; H=4m.kH<sub>2</sub>O</p> <p>Pompe qarkulluese binjake ( 1 Stand By) - e impjantit te ngrohjes per katin perdhe. Prurja 8 m<sup>3</sup>/h; H=8m.kH<sub>2</sub>O</p> <p>Pompe qarkulluese binjake ( 1 Stand By) - e impjantit te ngrohjes per katin perdhe. Prurja 10 m<sup>3</sup>/h; H=15m.kH<sub>2</sub>O</p> <p>Pompe antikondense e Kaldajes 5000 l/h, 40kPa</p> <p>Kolektori shperndares DN 1000 [4"], L=2m</p> <p>Elektrovalvol 3-rrugeshe modulante</p> <p>Ene zgjerimi 350 l</p> <p>Ndares Hidraulik</p> <p>Termometer 0/120C</p> <p>Manometer 0/6 bar</p> <p>Filter ujit mekanik DN 50</p> <p>Filter ujit mekanik DN 65</p> <p>Valvol me sferë M-F DN 15</p> <p>Valvol me sferë DN 20 [3/4"]</p> <p>Valvol moskthimi DN 40 (11/2 ")</p> <p>Valvol moskthimi DN 50 (2 ")</p> <p>Valvol moskthimi DN 65 (2 1/2")</p> <p>Valvol Butterfly DN 40 (11/2 ")</p> <p>Valvol Butterfly DN 50 (2 ")</p> <p>Valvol Butterfly DN 65 (2 1/2")</p> <p>Xhunto antivibruese DN 50 (2 ")</p> <p>Xhunto antivibruese DN 65 (2 1/2")</p> <p>Ajernxjerrës automatike ne kolone 1/2"</p> <p>Tubacione celiku te zi pa tegel, UNI 8863, te termoizoluara, bashke rakorderite perfshire sistemin e mberthimit dhe te fiksimit, riveshur me flete alumini 0.7mm</p> <p>Grup i mbushjes automatike 1/2", 1.5bar</p> <p>Sistemi i regullimit dhe I kontrollit te centralit termik, perfshire kuadri I fuqise centralit termik (pompa, elektrovalvola, etj), sondat e temperaturave, sonde te jashtme etj.</p> <p>Oxhaku dopio paret , bashke me aksesoret e nevojshem ( dritare inspektimi, shkarkim kondense etj) inox i termozoluar Db 400mm</p> <p>Radiatore alumini, me lartesi H=600 mm, element me gjeresi 120 mm. i kompletuar me valvola te nxjerrjes se ajrit, tapa, reduksione dhe detentore.</p> <p>Radiator, 8 elemente, Q=1200 Ë, L=960 mm</p> <p>Radaiator 10 elemente, Q=1500Ë, L=1200 mm</p> <p>Radiator, 12 elemente, Q=1800Ë, L=1440 mm</p> <p>Radiator, 15 elemente, Q=2250Ë, L=1800 mm</p> <p>Valvola termostatike per radiatore, tipi antivandal dhe me aksesore kunder vjedhjes</p>		
--	--	---	--	--

		Valvol balancuese per radiatore Aeroterm 24 kË, kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit dhe te fiskimit si dhe komandimin		
NS-14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Kabell rrjeti ÈLAN UTP cat6 PANDUIT blu 4-PR 24 AËG F.V Kutiderivacioni plastike F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T Vimar F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54 "Vimar" F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A "Vimar" F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Vimar" F.V Çeles deviat 220V 10A "Vimar" Tape fallco plastike 1 mod Prize Rrjeti RJ45 UTP cat5 8PIN NETSAFE 1mod Kabell FR-OR 450/750V fleksibel 3x1.5mm F.V Tub rixhid i ngurte d=20 Modul operimi ne anglisht Bateri 12V 25A Kabell per sinjalin e alarmit 2x1mm2 i kuq F.V Tub rixhid i ngurte d=20 Bokse tavanore 7Ë RCF Bokse te jashtme audio Fisha lidhese dhe konektore Kabell Audio 2x0.75mm F.V Tub rixhid i ngurte d=20 Pulsant i thjesht 1P 1mod 10A Sensor ndricimi inkaso 360grade i bardhe Sëitch me 24 porta RJ45 10/100 profesional Sëitch me 8 porta RJ45 10/100 i thejshte Rack 42 unit I kompletuar me te gjithë aksesoret Kuader metalik i kompletuar per katin 1 sipas skemes Kuader metalik i kompletuar per katin -1 dhe 0/1 sipas skeme Kuader metalik i kompletuar per gjithë godinen sipas skemes Ndricules Tabele Exit Ndricules emergjent 8Ë 2ore autonomi Central per alarmin e zjarrit i kompletuar me aksesoret e nevo Karte loop Detektore optik tymi Buton alarmi zjarrit Sirene e brendshme Sirene e jashtme Amplifikator me 4 kanale 120Ë Mikrofon lajmerimi RCF Ndricules LED 1.2ml 28Ë IP44 4000K Spote Led 10Ë IP67 Ndricules Led ne forme hinke 100Ë Ndricules Led ne forme globi dekorativ Ndricules Led i inkastruar ne toke 6Ë	Kategoria A	0-20 milion lekë

**2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim prej të paktën 40 (dyzetë) punonjës të siguruar për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosja e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështrirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve, mbështetur në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë



19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.4.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier hidroteknik
- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kjo kërkesë është përcaktuar pas analizimit që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet edhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë dhe marrë në konsideratë kompleksitetin e punimeve që do të realizohen, referuar këtu projekt-preventivit të zbatimit, është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit të tij, inxhinierët e kërkuar në këtë pikë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

*Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-1, NP-2, NS-1 dhe NS-4, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim inxhinier ndërtimi.*

*Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-7 dhe NS-2, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim inxhinier hidroteknik.*

*Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-11 dhe NS-14, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim inxhinier elektrik.*

*Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NS-3 dhe NS-12, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim inxhinier mekanik.*

*Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NS-18, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.*

*Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.*

**2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 6, gërma “c”.*

*Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune, detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika*

*1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

*Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.*

**2.3.6.** Operatori Ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se ka të punësuar me kontratë pune të vlefshme të paktën 1 (një) punonjës të specializuar/kualifikuar, të pajisur me dëshmi/certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”).

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për mbarëvajtjen, ndërhyrjen, parandalimin dhe evitimin e situatave apo problematikave lidhur me rreziqet, sigurinë dhe shëndetin në punë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet edhe në dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, VKM nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në dispozitat e akteve të sipërcituara, ndër të tjera parashikohet se: punëdhënësi merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm; organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit e punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre; punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës; çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Pra, në dispozitat e akteve të mësipërme, përcaktohen kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik, emergjencë apo të papritura në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës, i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës, duke patur në fokus primar jetën dhe shëndetin e punonjësve të angazhuar me zbatimin e punimeve.

**2.3.7.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 2 (dy) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 3 (tre) muratorë/suvatues, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

- 2 (dy) hekurkthyes, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 3 (tre) karpentier, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) pllakashtrues, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) bojaxhinj, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) elektrikist, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) hidraulik, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) manovratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi e aftësisë profesionale për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë D.A.P,(të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse;
- 2 (dy) shofer, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe leje drejtimi minimalisht kategoria C (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Për punonjësit më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën në sistemin e prokurimit publik me të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni i punonjësit	Emri i Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Numri indentifikues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT - (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
...					

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për stafin mbështetës të kërkuar në objekt, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Nëpërmjet këtij stafi, synohet realizimi i objektit të kontratës brenda afatit, normave dhe me cilësi sipas standardeve në fuqi. Staf mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.3.8.** Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 15 ton	Në pronësi ose me qira	Copë	2
2	Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5	Në pronësi ose me qira	Copë	2
3	Kamion me vinç	Në pronësi ose me qira	Copë	1
4	Eskavator	Në pronësi ose me qira	Copë	1
5	Fadromë	Në pronësi ose me qira	Copë	1
6	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	Copë	2
7	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	Copë	1
8	Vinç kulle	Në pronësi ose me qira	Copë	1
9	Betoniere kantieri	Në pronësi ose me qira	Copë	2
10	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Copë	2

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -certifikata e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -kontrata e qirasë; -certifikata e pronësisë së qiradhënësit; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.*

*Numri dhe lloji i mjeteve, makinerive e pajisjeve të cilat duhet të disponohen nga OE në një rënë prej formave të kërkuara, janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket disponimit të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, e për këtë qëllim janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave të përcaktuara. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në manualin e çmimeve në fuqi, si dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.*

- 2.3.9.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:
- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente,
  - Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente,

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 ose ekuivalente

*Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomikë si zbatues të punimeve, të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara, me qëllim për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarde që çdo subjekt duhet ti përmbushë në veprimtarinë e tij, pasi respektimi dhe ushrimi i veprimtarisë në përputhje me këto standarde, përveçse ndikon në arritjen e suksesit të subjektit, është njëkohësisht edhe një indikator që tregon besueshmëri për realizimin e punimeve në harmoni me standardet e cilësisë e duke mbajtur në vëmendje edhe kujdesin që duhet treguar për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Pra, nisur edhe nga vetë përcaktimi ligjor, kërkesat e përcaktuara sipas kësaj pike, janë në përputhje dhe harmoni me natyrën dhe përmasat e objektit që prokurohet.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. Çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO



*14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.*

*ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.*

**\*\*\***

### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Specifikimet Teknike për procedurën objekt prokurimi, janë hartuar nga shoqëria “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” shpk që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë element përbërës i tij.*

*Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Grafiku i zbatimit të punimeve:**

*Referuar grafikut, është parashikuar që ekzekutimi dhe zbatimi i punimeve objekt prokurimi të përfundojnë në një afat prej 12 muaj nga data e fillimit të punimeve.*

**Fondi limit:**

Referuar preventivit të punimeve, kostoja totale (fondi limit) për realizimin e punimeve të objektit, sipas preventivit të miratuar është **190,613,399** (njëqind e nëntëdhjetëmilion e gjashtëqind e trembëdhjetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) **Lekë me TVSH**, e zërthyer si më poshtë:

Punime:	149,523,307 lekë pa TVSH	179,427,968 lekë me TVSH
Fondi rezervë 3%:	4,485,699 lekë pa TVSH	5,382,839 lekë me TVSH
<b>Shuma:</b>	<b>154,009,006 lekë pa TVSH</b>	<b>184,810,807 lekë me TVSH</b>
<b>Paisje:</b>	<b>5,802,592 lekë</b>	<b>5,802,592 lekë</b>
<hr/>		
<b>Shuma Totale:</b>	<b>159,811,598 lekë pa TVSH</b>	<b>190,613,399 lekë me TVSH</b>
<hr/>		

**\*\*\***

Bazuar në parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik, por edhe në praktikat e aplikuara gjerësisht nga autoritetet kontraktore që prokurojnë fondet publike, si kriter vlerësimi përzgjidhet dhe përcaktohet: **“oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në *cmim*”**.

**\*\*\***

.....

**\*\*\***

.....

**\*\*\***

.....

**NJËSIA E PROKURIMIT**

.....